



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 589/5 Prot

Tiranë, më 24/6/2020

VENDIM

Nr. 16, datë 24 . 6 .2020

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesja, Shoqata “Together for life”, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 589 Prot., datë 28.05.2020, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesja, në cilësinë e kërkueses, nëpërmjet kërkesës datë 17.04.2020, depozituar në portalin “Pyet Shtetin.al”, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion dokumentacioni, si më poshtë vijon:

1. Sa është numri i mjekëve të regjistruar tek Urdhri i Mjekut të Shqipërisë;
2. Sa është numri i mjekëve specialist që janë të regjistruar tek Urdhri i Mjekut të Shqipërisë;
3. Sa është numri i mjekëve specialist në spitalet rajonale;
4. Sa është numri i mjekëve specialist në spitalet bashkiake;
5. Sa është numri i mjekëve specialist kirurgë në Shqipëri;
6. Sa është numri i mjekëve specialist anestezistë reanimatorë në Shqipëri;
7. Sa është numri i mjekëve specialist kardiokirurg në Shqipëri;
8. Sa është numri i mjekëve kirurgë peditër në Shqipëri;
9. Sa është numri i mjekëve specialist në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”;
10. Sa është numri i mjekëve specialist në Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi”;
11. Sa është numri i mjekëve specialist në Spitalin Universitar të Traumës;

12. Sa është numri i mjekëve specialist në Spitalin Rajonal Shkodër;
13. Sa është numri i mjekëve specialist në Spitalin Rajonal Durrës;
14. Sa është numri i mjekëve specialist në Spitalin Rajonal Vlorë;
15. Sa është numri i mjekëve specialist në Spitalin Rajonal Fier;
16. Sa është numri i mjekëve specialist në Spitalin Rajonal Berat;
17. Sa është numri i mjekëve specialist në Spitalin Rajonal Lezhë;
18. Sa është numri i mjekëve specialist në Spitalin Rajonal Elbasan;
19. Sa është numri i mjekëve specialist në Spitalin Rajonal Korçë;
20. Sa është numri i mjekëve specialist në Spitalin Rajonal Kukës;
21. Sa është numri i mjekëve specialist në Spitalin Rajonal Lushnje;
22. Sa është numri i mjekëve specialist në Spitalin Rajonal Dibër;
23. Sa është numri i mjekëve specialist në Spitalin Rajonal Gjirokastër.

Në mungesë të një përgjigje nga Autoriteti Publik, me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesja ka paraqitur ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit” dhe ankuesja legjitimohet në kërkimin e saj.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Zyra e Komisionerit, me Urdhrin nr. 82, datë 02.06.2020, vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik.

Pas depozitimit të urdhrin dhe regjistrimit të tij pranë Autoritetit Publik me nr. 2672 Prot., datë 05.06.2020, grupi i inspektimit kontaktoi me koordinatoren për të drejtën e informimit të Autoritetit Publik, me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave, që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Gjatë inspektimit, koordinatorja sqaroi se: “*Në lidhje me ankesën e paraqitur nga shoqata “Together for Life” është njohur pas paraqitjes së grupit të inspektimit në Autoritetin Publik. Pas verifikimit, rezultoi se kërkesa për informim, është depozituar në portalin “Pyet Shtetin.al”. Duke qenë në pamundësi për të aksesuar në këtë portal, për shkak të disa problemeve teknike, nuk ka mundur të njihet me kërkesën dhe për rrjedhojë ka qenë në pamundësi ta trajtojë atë brenda afatit ligjor. Për sa më sipër kërkoi mirëkuptimin e Zyrës së Komisionerit për përcjelljen e përgjigjes brenda ditës së mërkurë të datës 10 qershor 2020*”.

Në përfundim të procedurës së inspektimit, u hartua procesverbali i cili u nënshkrua pa vërejtje nga ana e koordinatorës për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik.

Në vijim, me shkresën nr. 2731 Prot., datë 09.06.2020, administruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 685 Prot., datë 11.06.2020, Autoriteti Publik ka deleguar për kompetencë dhe trajtim kërkesën për informacion pranë Urdhrit të Mjekut të Republikës së Shqipërisë (në vijim "UMSH"), në lidhje me pyetjet që lidhen me numrin e mjekëve dhe numrin e mjekëve specialistë të regjistruar pranë UMSH.

Ky i fundit me shkresën nr. 65/1 Prot., datë 10.06.2020, i ka kthyer përgjigje Autoritetit Publik, duke sqaruar ndër të tjerat se: *"...Numri i përgjithshëm i mjekëve të regjistruar pranë UMSH-së është 6315. Në këtë numër të sipërcituar janë të përfshirë të gjithë mjekët që ushtrojnë profesionin në Republikën e Shqipërisë, të gjithë mjekët që janë larguar nga Shqipëria por që nuk janë ç'regjistruar, mjekët pensionistë që nuk e ushtrojnë profesionin, si dhe mjekët e huaj. Numri i mjekëve specialistë të regjistruar në rang vendi është 2848. Numri i mjekëve me specialitet "Kirurgji e Përgjithshme" të regjistruar pranë UMSH-së është 174. Numri i mjekëve me specialist "Anestezi – Reanimacion" të regjistruar pranë UMSH-së është 143. Në lidhje me të dhënat e tjera, UMSH nuk mund të japë informacionin e duhur pasi, mjekët kur regjistrohen, anëtarësohen, licensohen ose ri licensohen nuk e kanë të detyruar të japin vendin e punës".*

Ndërkohë, Autoriteti Publik me shkresën nr. 2672/1 Prot., datë 09.06.2020 i ka kthyer përgjigje kërkuases, duke sqaruar ndër të tjerat se: *"...Për pjesën e pyetjeve që lidhen me numrin e mjekëve dhe numrin e mjekëve specialistë të regjistruar pranë Urdhrit të Mjekut, me shkresën nr. 2731 prot., datë 09.06.2020 "Përcjellje për kompetencë dhe trajtim", ka deleguar dhënien e përgjigjes për këto çështje drejt këtij institucioni kompetent. Për pyetjet e tjera, informojmë në total numrin e të punësuarve mjekë në sistemin shëndetësor publik është 4152 nga të cilët 1812 mjekë të përgjithshëm dhe 2340 mjekë specialistë..."*

Duke e konsideruar të paplotë përgjigjen e sipërcituar, ankuesja ka vijuar me ankimin nr.589/3 prot., datë 18.06.2020 me pretendimin se: *"Informacioni nuk është kërkuar për numrin total të mjekëve, por sipas strukturave përkatëse të cituara në kërkesën për informacion datë 17.04.2020".*

Nëpërmjet komunikimit elektronik të datës 19.06.2020, koordinatoresha për të drejtën e informimit pranë Autoriteti Publik ka informuar Zyrën e Komisionerit se: *"Në kërkesën e paraqitur është dhënë numri i përgjithshëm. Ashtu si edhe sqarohet, procedura e realizuar konsiston në përzgjedhjen e vendit të punës nga kandidati përkatës me plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm. Këto procedura realizohen sipas legjislacionit në fuqi, ku kandidatët në bazë të përzgjedhjes që bëjnë vetë për vendin e punës paraqiten në këtë vend të përzgjedhur. Rrjedhimisht subjektit i është sqaruar kjo procedurë, për të pasur parasysh në vijimësi dhe për të bërë të ditur që mund të kërkojë informacion në vendet e punës (në këtë rast strukturat) duke paraqitur kërkesën nominalisht, për numrat e përditësuar sipas rrethanave të faktit në këto struktura".* Duke

rikonfirmuar në këtë mënyrë edhe njëherë qëndrimin e mbajtur në shkresën nr. 2672/1 Prot., datë 09.06.2020.

Bazuar në sa më sipër, pas konsultimit të legjislacionit përkatës, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, përgjigja e Autoriteti Publik nuk është në përputhje me kërkesën për informacion të datës 17.04.2020.

Nga hetimi administrativ rezultoi se, Autoriteti Publik ka informuar kërkuesen se numri total i të punësuarve mjekë në sistemin shëndetësor publik është 4152 nga të cilët 1812 mjekë të përgjithshëm dhe 2340 mjekë specialistë. Ndërkohë që kërkuesja, nëpërmjet kërkesës për informacion të datës 17.04.2020 ka kërkuar të informohet specifikisht për numrin e mjekëve specialist për spitalet përkatëse. Në këtë kuptim detyrimi për informim konsiderohet i papërbushur nga Autoriteti Publik.

Gjithashtu, konstatohet se, me shkresën nr. 2731 Prot., datë 09.06.2020, administruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 685 Prot., datë 11.06.2020, Autoriteti Publik ka deleguar për kompetencë dhe trajtim, pranë UMSH-së, kërkesën për informacion përsa i përket pyetjeve që lidhen me numrin e mjekëve dhe numrin e mjekëve specialistë të regjistruar pranë këtij institucioni.

Në vijim, UMSH, me shkresën nr. 65/1 Prot., datë 10.06.2020, administruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 718 Prot., datë 15.06.2020, ka përcjellë informacionin në lidhje me pikat 1, 2, 5 dhe 6 të kërkesës për informacion. Nga shqyrtimi i saj, konstatohet se kjo shkresë nuk i është drejtuar kërkueses, por vetëm Autoritetit Publik. Për rrjedhojë ky i fundit detyrohet t'i vendosë në dispozicion kërkueses këtë informacion.

Ndërkohë, Zyra e Komisionerit vlerëson se, argumenti i koordinatores për të drejtën e informimit pas vijimit të ankimit, se subjekti mund të kërkojë informacionin në vendet e punës (në këtë rast strukturat përkatëse) duke paraqitur kërkesën nominalisht në këto struktura, nuk qëndron.

Në pikat 2 dhe 3 të nenit 12 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", parashikohet se:

2. "Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuesin.

3. Arsyeja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës një autoriteti tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar. Autoriteti publik, të cilit i është drejtuar kërkesa për informim, njofton kërkuesin se kërkesa e tij i është dërguar një autoriteti tjetër, si dhe e informon atë për kontaktet e autoritetit ku është dërguar kërkesa."

Sa më sipër, parashikohet gjithashtu dhe në germën “d”, të pikës 2, neni 10 i ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” sipas të cilit “*koordinatori për të drejtën e informimit dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar*”.

Bazuar në këto parashikime, Zyra e Komisionerit vlerëson se koordinatori për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik nuk ka vepruar në përputhje me detyrimin ligjor të përcaktuar për delegimin e kërkesës për informim tek *autoriteti kompetent* përkatës. Referuar vetë funksionit dhe përgjegjësive të Autoritetit Publik/Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, koordinatori për të drejtën e informimit gëzon kapacitetin dhe informacionin e nevojshëm për të identifikuar autoritetin publik përkatës, që disponon dokumentacionin e kërkuar, si rrjedhojë duhet të kishte trajtuar më tej kërkesën e paraqitur, në përputhje me nenin 12.

Për sa më sipër, informacioni i kërkuar objekt i këtij vendimi, përbën informacion publik në kuptim të pikës 2 të nenit 2 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, dhe rrjedhimisht i duhet venë në dispozicion kërkuases.

Ekzistenca e informacionit të mësipërm, pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit për vënien në dispozicion të tij kërkuases.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Shoqatës “Together for life” ndaj Autoritetit Publik/Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, “*Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit*”.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, neni 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 589 Prot., datë 28.05.2020 të Shoqatës “Together for life”, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar sipas kërkesës datë 17.04.2020, brenda datës 02 . 7 .2020.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 24 . 6 .2020.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

